

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga Kryetari i Gjykatës Enver Peci, kryetar kolegji, dhe gjyqtarët Emine Mustafa dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve D.M. dhe B.M., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit D.M., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal PPr.nr.39/2017 të datës 14.11.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1977/2017 të datës 17.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit D.M., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal PPr.nr.39/2017 të datës 14.11.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1977/2017 të datës 17.11.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktvendimin PPr.nr.39/2017 e datës 14.11.2017, të pandehurve D.M. dhe B.M., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, iu ka caktuar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila do të llogaritet nga data 12.11.2017 deri më datë 12.12.2017. Masa e paraburgimit iu është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.3 të KPPK-së.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.nr.1977/2017 e datës 17.11.2017, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe është vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit D.M., av. B.S., për shkak të caktimit të masës së paburgimit dhe zbatimit të ligjit në

mënyrë të gabuar dhe zbatimit të ligjit i cili nuk është dashur të zbatohet, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta vërtetojë kërkesën, t'i anulojë aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ate të shkallës së dytë dhe masën e paraburgimit ta ndërpej dhe të caktojë ndonjë masë më të butë.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit D.M., kryesisht thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë sa i përket caktimit të masës së paraburgimit ngase nuk ekzistojnë shkaqet ligjore, se vepra penale është kryer dhe nuk është në fazën e përgatitjes që të mund të përfundohet apo mund të kryhet vepra për të cilën është kanosur, se i pandehuri për herë të parë është i dyshuar për një veprë të till për të cilën ka shprehur pendim të thellë, është i gjendjes së dobët ekonomike, është i ndarë nga bashkëshortja dhe kujdeset për fëmijun 2 vjeçar, dhe që në fazën fillestare të procedurës ka treguar bashkëpunim me organet e drejtësisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.88/2017 e datës 27.11.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e çështjes, kryesisht nga kallëzimi penal, raportet e policisë, procesverbalet mbi intervistimin e dëshmitarëve, procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit D.M., me numër të rastit 2017-AF-0909 të datës 12.11.2017, e sidomos fakti se i pandehuri është kapur në flagrance, rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK për caktimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore, karakteristikat personale të pandehurit, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, e sidomos faktin se i pandehuri, së bashku me dy bashkëkryerësit tjerë, pas marrëveshjes paraprake me qëllim që vetit t'i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, me përdorimin e forcës, kanë depërtuar në shtëpinë e të dëmtuares duke i shkaktuar dëme të kosiderueshme materiale me që iu është demoluar shtëpia dhe i janë marrë një sasi e të hollave në vlerë prej 118 Euro, si dhe fakti se i pandehuri është i dyshuar edhe për një

rast tjetër penal, lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës së njëjtë penale.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.337/2017, më datë 30.11.2017

Bashkëpuntore profesionale
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i gjykatës - kolegjit,
Enver Peci